



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:107602

Datë: 26.06.2023

Numri i dokumentit: 04431460

PPP. Nr. 221/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Kosovare Musliu Prokshaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit: L.B., i përfaqësuar nga avokat V.Zh., me seli në Prishtinë, kundër debitorit F.C P. SH.P.K me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore në bazë të dokumentit përmbartimor, në vlerë prej 52,707.56 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr. 91/23, të datës 18.04.2023, i Përmbartuesit Privat, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.06.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit F.C P. SH.P.K me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.91/23 i datës 18.04.2023 i Përmbartuesit Privat.

A r s y e t i m

Zyra përmbartimore e Përmbartuesit Privat F.B. i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues – Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.NR.16/2022 e datës 26.10.2022, e lidhur në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prishtinë, ndërmjet debitorit FC P. SH.P.K me seli në Prishtinë, dhe kreditorit L.B. nga Prishtina.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor me date 27.04.2023 debitori ka paraqitur prapësim, i cili ka theksuar së e kundërshton urdhrin për përmbartim për shkak propozimi për përmbartim është paraqitur në bazë të dokumentit përmbartimor siç është Marrëveshja e ndërmjetësimit, e hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 22 të LPP-së, e që shuma e pa paguar nga ana e debitorit është prej 56,707.56 euro, e që është në kundërshtim me shumën që ka borxh debitori ndaj kreditorit, ku debitori kreditorit i ka paguar shumën prej 9,415.12 euro, nga 66.122.68 euro të cilën e pranon edhe kreditori, mirëpo debitori para ushtrimit të propozimit

kreditorit ia ka paguar edhe shumën prej 4,000.00 euro me dt. 17.04.2023, e cila në propozim është paraqitur si e pa paguar. I njëjti ka shtuar se gjykata gjatë shqyrtimit të prapësimit duhet të çmoj se dokumenti përmbartimor a i plotëson kushtet ligjore për të qenë i përmbartueshëm, për faktin se nga dokumenti përmbartimor nuk mundë të vërtetohet borxhi i cili kërkohet, dokumenti përmbartimor nuk e përmban objektin e detyrimit siç përcaktohet me LPP-në

Mbi bazën e kësaj i propozon Gjykatës Themelore në Prishtinë që të pranohet si i bazuar prapësimi dhe të anulohet urdhri P.nr 91/23 të dt. 18.04.2023 e lëshuar nga përmbartuesi privat.

Kreditori me datë 02.05.2023 ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilën ka theksuar se, fillimisht me anë të kësaj përgjigje e bëjnë ndryshimin e vlerës reale të borxhit që ka debitori ndaj kreditorit nga 56,707.56 euro, në 52,707.56 euro, sepse pas pranimit të prapësimit nga ana e debitorit kemi vërejtur se debitori ka paguar me dt. 17.04.2023 shumën prej 4,000.00 euro, për të cilën pagesë ne si palë kreditore nuk kemi qenë të njoftuar për atë arsye edhe propozimi për përmbartim është bërë në shumë prej 56,707.56 euro, mirëpo pasi që debitori e ka bërë pagesën në shumë e lartcekur, atëherë shuma e saktë e borxhit të cilën debitori obligohet ta paguaj ndaj kreditorit është shuma prej 52,707.56 euro. Tutje ka shtuar se sa i përket pretendimit se dokumenti mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri përmbartimor, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë si dhe nuk dihet objekti i detyrimit, këtë e kundërshtojmë në tërësi si të pa bazuar për faktin se Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.NR.16/2022 e dt. 26. tetor 2022, i përmbush të gjitha tiparet të cilat kërkohen në bazë të LPP-së, përkatësisht neni 22 par.1 pika 1.4, përkatësisht neni 5 të Ligjit nr. 05/L118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L139 për Procedurën Përmbartimore.

Andaj mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që të ekzekutohet përmbartimi për arsye se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara, për faktin se debitori nuk e ka përmbush detyrimin, dhe i njëjti po ashtu nuk e ka kontestuar, ku vërehet nga prapësimi i dorëzuar nga ana e debitorit i cili e ka pranuar borxhin.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse të paraqitura në prapësim si dhe përgjigjes në prapësim, ka ardhur në përfundim së prapësimi është i pa bazuar.

Gjykata ka vlerësuar së dokumenti përmbartues - Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.NR.16/2022 e dt. 26. Tetor 2022, përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase i plotëson të gjitha kushtet ligjore nga Neni 25 par. 1 dhe 27 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim. Për më tepër, Neni 22, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore shprehimisht përcakton se “*dokumente përmbartuese, sipas këtij ligji janë: pika 1.4, marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ne pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës*”, si dhe neni 5 të Ligjit nr. 05/L118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L 139 për Procedurën Përmbartimore përcakton: *Neni 22 i ligjit bazik paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. pas fjalës “ ndërmjetësimin ” fshihen fjalët “pas aprovimit të Gjykatës”.*

Dokumenti përmbartes–Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.NR.16/2022 e datës 26.10.2022, e lidhur në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prishtinë, ndërmjet debitorit F.C P. SH.P.K me seli në Prishtinë, dhe kreditorit L.B. nga Prishtina, mbi bazën e të cilit është lëshuar Urdhri për Përmbartim i plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u përmbartuar dhe atë mbi bazën e dispozitave të lartpërmendura. Rrjedhimisht, ky dokument paraqet një dokument të përmbartesishëm dhe të ekzekutueshëm sipas dispozitave të lartpërmendura të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Në rastin konkret debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave duhet të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit e të cilat janë paraparë në Nenin 71, paragrafi 1, pika 1 deri në pikën 12 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Rrjedhimisht, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
PPP. Nr. 221/23, datë 26.06.2023

Gjyqtarja,
Kosovare Musliu Prokshaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, në kopje të mjaftueshme.